



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 28
Prishtinë, më 04. 11. 2009, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Gashi, Ardian Gjini dhe Slobodan Petroviq.

Munguan: Enis Kervan dhe Nexhat Daci.

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit ishin: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 2. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2009;**
- 3. Rregullorja për formimin e grupeve të miqësisë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari i Komisionit i njoftoi anëtarët se në bazë të vendimit të seancës plenare, përbërja e Komisionit ka ndryshuar dhe tani Komisioni përbëhet prej nëntë anëtarëve. I falënderoi deputetët që nuk janë më anëtarë të këtij komisioni, për kontributin e dhënë dhe i dëshiroi mirëseardhje anëtarit të ri të Komisionit, S. Petroviq nga GP - SLS.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua njëzëri.

2. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2009;

Sabri Hamiti - I njoftoi anëtarët e Komisionit se është marrë vendim në Kryesinë e Kuvendit, që Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2009, të diskutohet në seancë të veçantë, me kërkesë të një grupi parlamentar dhe të Komisionit për Integritet Evropian. Po ashtu

të shqyrtohet edhe në të gjitha komisionet parlamentare. Raporti është shumë kritik lidhur me sundimin e ligjit, me gjyqësinë dhe me prokurimet, por sa i përket Kuvendit është bërë një vlerësim real.

Një mosbaraspeshë në këtë raport është në vlerësimin e pranisë ndërkombëtare në Kosovë, EULEX-in, ku nuk është monitoruar saktësisht puna e tyre, sepse në një mori fushash që lidhen me dobësitë që ndodhin në shoqërinë e Kosovës, janë të lidhura me misionet që EULEX-i i ka në Kosovë, siç janë dogana, sistemi i drejtësisë dhe ai i sigurisë. Faktori i vendit i ka përgjegjësitë që i takojnë, por çështjet që nuk i udhëheq, është mirë t'i adresohen atij që i ka përgjegjësitë. Ky raport tenton ta krijojë mundësinë e zhvillimit të Kosovës nga integrimet evropiane, ku sublimohen edhe disa konkludime, ndër të cilat tri pika themelore janë: gjetja e rrugës për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, ecja drejt Marrëveshjes së stabilizim asocimit, si dhe zhvillimi ekonomik për krijimin e marrëveshjes tregtare me BE-në.

Nënshkrimi i Traktatit të Lisbonës, edhe nga ana e Çekisë, konsiderohet moment i rëndësishëm, për faktin se për shumë vendime, ku do të implikohet edhe Kosova në të ardhmen, nuk kërkohet pëlqimi prej 27 shteteve anëtare të BE-së.

Meqë në seancë plenare do të diskutohet Raporti i Progresit, propozoi që një anëtar i Komisionit të referojë në seancë për Raportin.

Ibrahim Gashi - Mendon se pasi Komisioni për Integritet Evropian është i thirrur të diskutojë dhe të përgatisë raport lidhur me Raportin e Progresit. Nuk ka nevojë të ketë referues në seancë nga Komisioni për Punë të Jashtme, por të diskutohet në cilësi të anëtarëve të Komisionit.

Ardian Gjini - Theksoi se nga Komisioni mund t'i rekomandohet Kryesisë që Raportin e Progresit ta radhitë për shqyrtim në seancë, po edhe mund të caktohet një raportues nga Komisioni me një raport të shkurtër.

Komisioni pas diskutimeve nxori këtë

P e r f u n d i m

Nuk është i nevojshëm caktimi i raportuesit për seancë plenare nga Komisioni për Punë të Jashtme, lidhur me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2009.

2. Rregullorja për formimin e grupeve të miqësisë;

Sabri Hamiti - Lidhur me Rregulloren për formimin e grupeve të miqësisë tha se Komisioni ynë ka bërë një aktivitet fillestar, duke i orientuar kërkesat që Kuvendi i Kosovës të krijojë raporte më specifike të interesave me parlamentet e tjera, nëpërmjet Kryesisë së Kuvendit. Gjer më tani Kryesia ka vendosur të formohen grupet e miqësisë me Kuvendin e Madh Popullor të Turqisë, me Asambleenë Nacionale të Francës, me Bundestagun Gjerman, si dhe me Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar.

Për këto grupe të miqësisë është hartuar një Projektregullore e shkurtër, që sipas detyrës duhet ta miratojë Kryesia e Kuvendit.

Xhavit Haliti - Propozoi që në rregullën 3 për krijimin e grupeve të miqësisë, kriteri i ekzistimit të marrëdhënieve diplomatike ndërmjet një parlamenti dhe Kosovës, aktualisht nuk do të duhej të figuronte.

Sabri Hamiti - Përkrahu vërejtjen e deputetit Xh. Haliti dhe propozoi që në rregullën 3 fjala diplomatike të hiqet.

Ibrahim Gashi - Propozoi që në rregullën 3 fjalët “ *ekzistenca e marrëdhënieve diplomatike*” të zëvendësohen me fjalët “ *ekzistimi i vullnetit për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike*”.

Ardian Gjini - Propozoi në rregullën 3 fjalët “ *ekzistenca e marrëdhënieve diplomatike*” të zëvendësohen me fjalët “ *vullneti i dyanshëm për marrëdhëniet*”.

Pas propozimeve të anëtarëve, kryetari i Komisionit konstatoi se në rregullën 3 të Projektregullores për formimin e grupeve të miqësisë fjalët “ *ekzistenca e marrëdhënieve diplomatike* “ të zëvendësohen me fjalët “ *marrëdhëniet e tij* “.

Ardian Gjini - Shprehu dyshimin se rregulla 10.2 duhet të jetë e paraparë në këtë rregullore, pasi mendon se rregulla për kursimin e buxhetit të Kuvendit nuk duhet të parashihet fare në rregullore, por të rregullohet me anë të një vendimi të Kryesisë.

Sabri Hamiti - Tha se çdo udhëtim i grupeve të miqësisë dhe çdo ftesë, duhet të lejohet paraprakisht me vendim të Kryesisë.

Slobodan Petroviq -E përkrah në parim miratimin e Rregullores për formimin e grupeve të miqësisë. Me qëllim që t’u jepet rëndësi më e madhe këtyre grupeve, propozoi që në kuadër të tyre, varësisht se cili komision do të vizitohet jashtë vendit, kryetari ose një anëtar i delegacionit tonë, të jetë nga i njëjti komision ynë.

Pas diskutimeve edhe të deputetëve Ramë Buja e Lutfi Haziri, Komisioni nxori këtë

P e r f u n d i m

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës ta miratojë Projektregulloren për formimin e grupeve të miqësisë, me ndryshimin në rregullën 3, ndërsa propozimi për rregullën 10.2 të paraqitet si alternativë drejtpërdrejt në mbledhjen e Kryesisë.

3. Të ndryshme.

Sabri Hamiti – I njoftoi anëtarët e Komisionit se nëpërmjet Ambasadës së Francës i është bërë ftesë grupit të miqësisë të Francës që të vijë për vizitë. Është marrë konfirmimi se ata janë të interesuar dhe të gatshëm, që në fillim të vitit ta realizojnë vizitën te ne.

Ibrahim Gashi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se pas njohjes së Pavarësisë nga shteti i Maltës, në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit, në muajin mars i është shkruar një ftesë kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme të Maltës, që ta vizitojë Kuvendin e Kosovës.

Kjo ftesë është përcjellë para një jave dhe është mirëpritur nga kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme të Maltës, i cili ka shprehur gatishmëri që ta vizitojë Kuvendin e Kosovës në fillim të dhjetorit.

Mbledhja përfundoi në orën 10: 50

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:
Njësia për Mbështetje të Komisionit